
THE PROCEDURE OF EXAMINATION OF HEREDITARY ESTATE

Shemsije Demiri

International University of Struga E-mail: sh.demiri@eust.edu.mk

Senada Lacka

International University of Struga E-mail: s.lacka@eust.edu.mk

Abstract: The heritage institution is considered to be one of the oldest civil law institutions and also presented as a social factor in every society. The inheritance law is multiple, the fundamental role of the heritage institute is to incorporate into the legal process of a legal relationship of one. If with the death of physical persons, all their rights and obligations would end, then a number of negative consequences for the society and individuals will be established. First of all, legal relations would become unsafe, many would experience the danger that everything would collapse because of the death of any subject. This insecurity would slow down and slow the circulation of goods, the legal relations between people.

Among the procedures for the regulation of property relations, the procedure for the examination of inheritance is one of the most important procedures, the biggest and at the same time with more innovation. The main innovation of the new law on non-contentious procedure is the right of notaries who, in the capacity of trustees of the court, act in non-disputed inheritance cases. Such a step is intended to ensure greater efficiency in the hereditary procedure. At the same time, this will have the effect of dismissing the courts from non-contentious cases and increasing the efficiency of the work of the courts as an important condition for the realization of citizens' rights and judicial protection.

In the procedure for the examination of the hereditary estate, the court determines who are the heirs of the deceased (de kujus) which property constitutes his or her hereditary estate and which rights but also obligations from the hereditary estate belong to heirs, legates and other persons.

Keywords: The object of the procedure, the subjects involved, the jurisdiction of the court, the meaning of the act of death, notaries as court representatives, Notary powers.

PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN E PASURISË TASHËGIMORE

Shemsije Demiri

International University of Struga E-mail: sh.demiri@eust.edu.mk

Senada Lacka

International University of Struga E-mail: s.lacka@eust.edu.mk

Abstrakt: Institucioni i trashëgimisë konsiderohet si një ndër institucionet më të vjetra të së drejtës civile dhe paraqitet edhe si një faktor social në çdo shoqëri. Roli i të drejtës trashëgimore është i shumëfishtë, roli themelor i institutit të trashëgimisë është përfshirja në procesin e trashëgimisë të marrëdhënieve juridike të një individi. Në qoftë së me vdekjen e personave fizike do të merrnin fund të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij, do të shkakttoheshin një sere pasojash negative për shoqërinë dhe individët. Në radhe të parë marrëdhëniet juridike do të bëheshin të pasigurta, te shumëkush do të shfaqej rreziku se papritmas do të rrënohej për shkak të vdekjes së ndonjë subjekti. Kjo pasiguri do të veshtirësonte e ngadalësonte qarkullimin e mallrave, marrëdhëniet juridike midis personave.

Ndër procedurat për rregullimin e marrëdhënieve pasurore, procedura për shqyrtimin e trashëgimisë është njëra nga procedurat më të rëndësishme, më të mëdha e njëherit edhe me më tepër risi. Risia kryesore që solli ligji i ri mbi procedurën jokontestimore është e drejta e noterëve, që në cilësinë e të besuarve të gjykatës të vepron në lëndët trashëgimore që nuk janë kontestuese. Një hap i tillë ka për qëllim të siguroj efikasitet më të madh në procedurën trashëgimore. Njëkohësisht kjo do të ndikojë në shkarkimin e gjykatave nga lëndët jokontestimore dhe ritjen e efikasitetit të punës së gjykatave, si kusht i rëndësishëm për realizimin e të drejtave të qytetarëve dhe mbrojtjes gjyqsore.

Në procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata konstaton se kush janë trashëgimtarët e të vdekurit (de kujusit) cila pasuri përbën pasurinë trashëgimore të tij dhe cilat të drejta por edhe obligime nga pasuria trashëgimore u takojnë trashëgimtarëve, legatarëve dhe personave të tjerë.

Fjalë kyçe: Objekti i procedurës, subjektet pjesmarrëse, kompetenca e gjykatës , kuptimi i aktvdekjes , noterët si përfaqësues të gjykatës, kompetencat e Noterit.

HYRJE

Ndër procedurat për rregullimin e marrëdhënieve pasurore, procedura për shqyrtimin e trashëgimisë është njëra nga procedurat më të rëndësishme, më të mëdha e njëherit edhe me më tepër risi. Risia kryesore që solli ligji i ri mbi procedurën jokontestimore është e drejta e noterëve, që në cilësinë e të besuarve të gjykatës të veprojnë në lëndët trashëgimore që nuk janë kontestuese. Një hap i tillë ka për qëllim të sigurojë efikasitet më të madh në procedurën trashëgimore. Njëkohësisht kjo do të ndikojë në shkarkimin e gjykatave nga lëndët jokontestimore dhe ritjen e efikasitetit të punës së gjykatave, si kusht i rëndësishëm për realizimin e të drejtave të qytetarëve dhe mbrojtjes gjyqsore.³²⁴

Në procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata konstaton se kush janë trashëgimtarët e të vdekurit (*de kujusit*) cila pasuri përbën pasurinë trashëgimore të tij dhe cilat të drejta por edhe obligime nga pasuria trashëgimore u takojnë trashëgimtarëve, legatarëve dhe personave të tjerë.

Procedura për shqyrtimin e trashëgimisë inicohet sipas detyrës zyrtare, menjëherë pasi të njoftohet gjykata për vdekjen e personit ose se personi i zhdukur është shpallur si i vdekur.³²⁵

Gjykata ka për detyrë të kujdeset që palët sa më shpejtë të njoftohen se cilat të drejta i takojnë në pasurinë e trashëgimlënësit. Ajo sidomos duhet të kujdeset që sa më shpejtë të konstatohen dhe sigurohen të drejtat e personave që gëzojnë mbrojtje të posaçme ligjore. Gjykata i merr parasysh dhe i vlerëson të gjitha propozimet e personave të interesuar që janë parashtruar me shkrim. Gjykata mund të mbështes vendimin meritor sikurse mbi rezultatin e provave të cilat vetë i ka proceduar ashtu edhe në ato të proceduara nga ndonjë gjykatë tjetër.

1. OBJEKTI I PROCEDURËS

Përbërja e objektit të trashëgimisë mund të përkufizohet si tërësi e të drejtave të trashëgimlënësit në kohën e vdekjes së tij, të përshtatshme për trashëgimi. Të përshtatshme për trashëgimi konsiderohen të drejtat që përbëjnë objektin e trashëgimisë si: 1) të drejtat reale (e drejta e pronësisë, pengut, servituteve, posedimi, etj), 2) të drejtat e detyrimeve (kontrata e shitblerjes, shpërblimi i dëmit, pasurimi pa bazë, depozita, premitë e sigurimeve etj.) dhe 3) e drejta e autorit dhe e drejta e pronësisë indusrtiale.

Me vdekjen e një personi ose me sjelljen e vendimit të plotëfuqishëm me të cilën personi i zhdukur shpallet i vdekur, pasuria e tij kalon tek trashëgimtarët sipas fuqisë së ligjit (*ispo jure*). Edhe pse pasuria trashëgimore e personit të vdekur kalon tek trashëgimtarët e tij sipas fuqisë së ligjit në momentin e vdekjes së tij, është e nevojshme të ndërmeren veprime të caktuara edhe atë jo vetëm nga organi që është kompetent për zhvillimin e procedurës por edhe nga organet e tjera, nga trashëgimtarët, dhe personat e tjerë që realizojnë ndonjë të drejtë nga trashëgimia. Pra është e rëndësishme të konstatohet se: a) kush janë trashëgimtarët tek të cilët do të kalojë pasuria trashëgimore, b) nga cila pasuri përbëhet masa trashëgimore (sendet e luajtshme dhe të paluajtshme pronësi e trashëgimlënësit, të drejtat të cilat i kanë takuar trashëgimlënësit, respektivisht kërkesat që i ka pasur ndaj personave të tretë, si dhe detyrimet që i ka pasur ndaj personave të tretë), c) sipas cilës bazë trashëgojnë (sipas ligjit ose me testament), ç) sa janë pjesët e tyre trashëgimore, nëse trashëgimlënësi ka lënë testament, nëse ka dhe kush janë legatarët, të cilët i kanë marrë obligimet e trashëgimlënësit nëse ka të tillë, kush do ti paguajë harxhimet e procedurës si dhe një seri pyetjesh që janë të ndërlidhura me zhvillimin e procedurës trashëgimore.³²⁶

Në të drejtën trashëgimore të R. së Maqedonisë mungon dispozitë me të cilën do të parashkohet se të drejtat dhe detyrimet personale të cilat janë të lidhura me personalitetin e trashëgimlënësit nuk hynë në masën trashëgimore. Ato pushojnë së egzistuari në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Edhe pse në të drejtën tonë egzistojnë zbrazëtira ligjore lidhur me rregullimin e kësaj çështje në shtetet e tjera kjo është e rregulluar me dispozita të veçanta, si psh. Në Rusi ligjvënësi parasheh se: të drejtat dhe detyrimet që janë të pandashme nga personaliteti i trashëgimlënësit, a posaçërisht e drejta në mbajtje, e drejta në kompenzimin e dëmit për shkak të rrezikimit të jetës dhe shëndetit, si dhe të drejtat dhe detyrat të cilat sipas këtij ose ligjeve të tjera nuk trashëgohen, nuk përbëjnë masë trashëgimore.

³²⁴ Zendeli Emine, Vizione, pp.78-87 , Grafotex Skopje Makedonija 1/2009 ISBN 1409-8962

³²⁵ Закон за вонпарнична постапка, сл.весник на РМ, член.120,121, 18.01.2008, стр.67-бр.9

³²⁶ Јаневски Аерсен, Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр.111,112

Përveç të drejtave dhe detyra që janë të lidhura ngushtë me personalitetin e trashëgimlënësit (*intuitu personae*) si e drejta në emer, në nderë, si dhe të drejtat familjare të karakterit personal, që nuk janë objekt i trashëgimisë, egziston dhe një pasuri tjetër që nuk hynë në masën trashëgimore. Këtu bëhet fjalë për pjesën e pasurisë së përbashkët të bashkëshortit pasjetues, sendet shtëpiake, si dhe ndarja e pasurisë personat që kanë jetuar së bashku me trashëgimlënësin.³²⁷

1.2. Subjektet pjesëmarrës në procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore

Subjekte pjesëmarrës në procedurën për zhvillimin e trashëgimisë janë trashëgimtarët, legatarët dhe personat e tjerë të cilët realizojnë ndonjë të drejtë nga trashëgimia. Pjesëmarrës në procedurë nuk është vetëm personi i cili mer veprime aktive në procedurë, por edhe ai pjesëmarrës i cili në procedurë nuk mer pjesë efektivisht por, për procedurën është i thirrur në mënyrë të rregullt. Organi që e zhvillon procedurën trashëgimore është i obliguar ti thërras të gjithë palët në procedurë (trashëgimtarët, legatarët, nëse ka të tillë, dhe personat e tjerë të cilët nga trashëgimia realizojnë ndonjë të drejtë).³²⁸

Pjesëmarrësit në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë janë: pasardhësit dhe trashëgimtarët dhe personat e tjerë të cilët realizojnë ndonjë të drejtë të trashëgimisë.³²⁹

1.3. Kompetenca e gjykatës në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë

Në dispozitat e nenit 126 dhe 129 të Ligjit për procedurë jokontestimore, është përcaktuar kompetenca e gjykatës në çështjet trashëgimore. Për shqyrtimin e trashëgimisë së shtetasit të Republikës së Maqedonisë, lidhur me pasurinë e tij e cila gjendet brenda teritorit të saj, ekskluzivisht është kompetent Gjykata e Republikës së Maqedonisë, respektivisht noteri si i besuar i gjykatës, gjithashtu, është ekskluzivisht kompetente për shqyrtimin e trashëgimisë së sendeve të luajtshme, të shtetasit të Republikës së Maqedonisë në botën e jashtme, do të jetë kompetente vetëm nëse sipas ligjit të vendit ku gjenden paluajtshmëritë nuk është kompetent organi i huaj.³³⁰

Gjykata obligohet që çështjen lidhur me trashëgiminë t'ia besojë në kompetencë noterit, në mënyrë që ai të udhëheqë procedurën trashëgimore.

Gjykata mund t'ia besojë noterit zbatimin e procedurës së trashëgimisë dhe do t'ia dorëzoj lëndën e trashëgimisë me të gjitha shënimet, në afat prej 8 ditësh nga dita kur lënda do të regjistrohët. Kur noteri zbaton veprime në procedurën trashëgimore si përfaqësues i gjykatës, është i autorizuar ti ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurën dhe ti marrë të gjitha vendimet përveç atyre për të cilat me këtë ligj është përcaktuar ndryshe.

Kundër vendimit të noterit i cili vepron si i besuar i gjykatës, lejohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit pjesëmarrësit në procedurë. Kundërshtimi i dorëzohet noterit i cili është i detyruar pa prolongim, por më së voni në afat prej 3 ditësh, së bashku me shënimet dhe aktet e tjera t'ia dorëzoj gjykatës kompetente e cila i'a ka besuar çështjen. Lidhur me kundërshtimin ndaj vendimit të noterit do të vendosë gjykatësi individual.

Kundërshtimi jo në kohë, jo i plotë ose kundërshtimin e palejuar, gjykatësi do ta hedhë poshtë. Duke vendosur për kundërshtimin kundër aktvendimit që e ka miratuar noteri, gjykata në tërësi ose pjesërisht aktvendimin mund ta vërtetoj ose anulojë. Kur gjykatësi aktvendimin pjesërisht do ta anuloj ose pjesërisht do ta vërtetoj, vetë do të vendos për pjesën e anuluar të aktvendimit. Kundër aktvendimit të gjykatës në të cilin aktvendimi i noterit në tërësi ose pjesërisht është anuluar lejohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dorëzimi i aktvendimit të shkallës së parë. Aktvendimi pas kundërshtimit u dorëzohet pjesëmarrësve dhe noterit. Ndaj aktvendimit të noterit kundër të cilit është inicuar kundërshtimi, ndërsa gjyqtari e ka hedhur poshtë, klauzulën për plotëfuqishmëri e vendos gjykata që vendos sipas kundërshtimit. Aktvendimi i noterit kundër të cilit nuk është inicuar kundërshtim është i plotëfuqishëm. Klauzolën për plotëfuqishmërinë e këtij aktvendimi e vendos noteri.

Gabimet në emrat dhe numrat, si dhe gabimet tjera të dukshme në shërbimin dhe llogaritjen do ti përmirësoj ai që ka miratuar aktvendimin. Përmirësimet do të kryhen me aktvendim të veçantë, ndërsa pjesëmarrësve do tu dorëzohet aktvendim i posaçëm.

Për shqyrtimin e trashëgimisë kompetencë vendore ka gjykata në teritorin e të cilës trashëgimlënësi në kohën e vdekjes ka pasur vendbanim të përhershëm përkatësisht vendqëndrim (gjykatë trashëgimore). Nëse trashëgimlënësi në kohën e vdekjes nuk ka pasur vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë, për shqyrtimin e trashëgimisë kompetencë vendore ka gjykata në rajonin e të cilit trashëgimlënësi ka pasur trashëgimore, ndërsa

³²⁷ Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, Закон за наследувањето, Скопје 2015, стр.40,41

³²⁸ Јаневски Аерсен, Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр.112

³²⁹ Закон за вонпарнична постапка, сл.весник на РМ,член.125, стр.67-бр.9, 18.01.2008

³³⁰ Zendeli Emine, Visione, pp.78-87, Grafotex Skopje Makedonija 1/2009 ISBN 1409-8962

trashëgimtarët e tij kanë dorëzuar kërkesë për iniciimin e procedurës trashëgimore. Nëse asnjë pjesë e trashëgimisë nuk ndodhet në Republikën e Maqedonisë, gjykatën kompetente e përcakton gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Gjykata në rajonin e të cilit ka vdekur trashëgimlënësi, përkatësisht gjykata në rajonin e të cilit ndodhet pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit, mund të caktoj masa të përkohshme për sigurimin e trashëgimisë.³³¹

Gjykata në Republikën e Maqedonisë ka kompetencë ekskluzive për shqyrtimin e procedurës trashëgimore për masën trashëgimore të paluajtshme të shtetasit të vet, nëse ajo masë trashëgimore gjindet në Republikën e Maqedonisë (neni 84, paragrafi 1, LDNP). Nëse paluajtshmëria e shtetasit të Republikës së Maqedonisë ndodhet në shtetin e huaj kompetenca e gjykatës të R.Maqedonisë egziston nëse sipas rregullit të shtetit në të cilën ndodhen paluajtshmëritë nuk është kompetent organi i shtetit (neni 84, par.2, LDNP).

Për zhvillimin e procedurës trashëgimore të paluajtshme të shtetasit të huaj ekskluzivisht është kompetent gjykata e R.Maqedonisë, nëse paluajtshmëritë gjenden në R.M (neni 85, par.1 LDNP). Për zhvillimin e trashëgimisë së paluajtshme të shtetasit të huaj e cila gjendet në R.M kompetent është gjykata e R.Maqedonisë, përveç nëse në shtetin e trashëgimlënësit, gjykata nuk është kompetent për shqyrtimin e trashëgimisë së pasurisë së paluajtshme të shtetasit të R.Maqedonisë (neni 85, par.2 LDNP).

Për zhvillimin e procedurës trashëgimore për paluajtshmëritë, për personin pa shtetësi, personin shtetësia e të cilit nuk mund të vërtetohet ose personi i cili ka cilësinë ose statusin e refugjatit, kompetenca e gjykatës së R.Maqedonisë egziston nëse paluajtshmëritë gjenden në teritorin e R.Maqedonisë ose nëse trashëgimlënësi në kohën e vdekjes ka pasur vendbanim në Republikën e Maqedonisë (neni 86, par.2, LDNP).³³²

Për shqyrtimin e trashëgimisë kompetencë territoriale ka gjykata në teritorin e të cilit trashëgimlënësi në kohën e vdekjes ka pasur vendbanim apo vendqëndrim të rregullt (*forum generale*). Nëse trashëgimlënësi në kohën e vdekjes nuk ka pasur vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë, për shqyrtimin e trashëgimisë kompetencë territoriale ka gjykata në rajonin e të cilit trashëgimlënësi ka masë apo pasuri trashëgimore, ndërsa trashëgimtarët kanë iniciuar procedurë për zhvillimin e procedurës trashëgimore. Nëse asnjë pjesë e trashëgimisë nuk gjendet në teritorin e Republikës së Maqedonisë, kompetencën territoriale do ta caktoj gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë (*forum ordinatum*). Për shqyrtimin e trashëgimisë është kompetent gjykatsëi individual, respektivisht noteri si i besuar i gjykatës, funksionalisht kompetent është edhe këshilli kur vendoset sipas ankesës ose revizionit.³³³

1.3.1. Nocioni dhe kuptimi i aktvdekjes

Aktvdekja është dokument publik, i cili përmban të dhëna për vdekjen e një personi. Përmbajtja si dhe të dhënat e tjera kanë rëndësi dhe interes jo vetëm për fillimin e procedurës, por edhe vazhdimin e saj në çdo rast konkret. Aktvdekja është sinjal i parë për gjykatën që të inicioj procedurën trashëgimore.³³⁴

1.3.2. Përpilimi i aktvdekjes dhe përmbajtja e aktvdekjes

Kur ndonjë person do të vdesë ose do të shpallet si i vdekur, ofiqari është kompetent të bëjë regjistrimin e vdekjes në librin amë të të vdekurve dhe është i detyruar që, në afat prej 30 ditësh nga dita e vdekjes, t'ia dorëzojë aktvdekjen gjykatës për trashëgimi. Nëse ofiqari nuk mund ti grumbullojë të gjitha të dhënat për përpilimin e aktvdekjes do t'ia dorëzojë gjykatës aktvdekjen vetëm me të dhënat me të cilat disponon dhe do t'i nxjerrë shkaqet pse nuk mund ta dorëzojë aktvdekjen, duke theksuar edhe të dhënat të cilat do të mund t'i hyjnë në përdorim gjykatës për gjetjen e trashëgimtarëve dhe pronën e të vdekurit. Nëse ndonjë person ka vdekur jashtë teritorit të komunës në të cilën ka vendbanimin, përkatësisht, vendqëndrimin, ofiqari do të mund t'ia dorëzojë gjykatës për trashëgimi vetëm çertifikatën e vdekjes nga libri amë i të vdekurve, si dhe të dhënat me të cilat disponon, e që mund të shërbejnë për përpilimin e aktvdekjes. (neni 142, LPJ).

Nëse gjykatës i është dorëzuar aktvdekje jo e plotë, ose vetëm çertifikatë nga libri amë i të vdekurve, gjykata mund të përpilojë aktvdekje ose përpilimin e aktvdekjes t'ia besojë ofiqarit kompetent.

Gjykata mundet, kur ajo është e njëtrajtshme, vetë mund të përpilojë aktvdekje dhe jashtë rastit nga paragrafi 1, në këtë ligji, nëse me çertifikatën nga libri amë i të vdekurve ose me dokumente të tjera publike është vërtetuar vdekja e ndonjë personi ose shpallja e tij e vdekur. (neni 143, LPJ),

³³¹ Закон за вонпарнична постапка, сл.весник на РМ, член 129,130, стр.67, 68-бр.9, 18.01.2008

³³² Јаневски Аерсен, Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр. 112,113

³³³ По ату fq.114

³³⁴ Јаневски Аерсен, Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр. 121

Aktivdekja përpilohet gjithmonë kur ndonjë person vdes ose shpallet si i vdekur, pa marr parasysh se a ka ose nuk ka pasuri. Aktivdekja përpilohet në bazë të të dhënave të të afërmeve të të ndjerit, personave me të cilat trashëgimlënësi ka jetuar, si dhe prej personave të tjerë që mund të japin të dhëna për përpilimin e aktivdekjes.³³⁵

Aktivdekja i përmban këto të dhëna:

- 1) Emrin, emrin e babait dhe mbiemrin e të vdekurit, ndërsa për të vdekurit persona të gjinisë femrore edhe mbiemrin e vajzërisë, profesionin e të vdekurit, datëlindjen e tij, shtetësinë dhe numrin amë;
- 2) Diten, muajin dhe vitin, dhe sipas mundësisë edhe orën e vdekjes dhe vendin e vdekjes;
- 3) Vendi në të cilin i vdekuri ka pasur vendbanimin respektivisht vendqëndrimin;
- 4) Mbiemrin dhe emrin, datëlindjen, profesionin, vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e bashklëshortit të të vdekuri dhe të fëmijëve të tij;
- 5) Mbiemrin dhe emrin, datëlindjen dhe vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e familjarëve të tjerë dhe personave të cilët do të mund të thiren në trashëgimi në bazë të ligjit, dhe personave që thiren në trashëgimi në bazë të testamentit dhe
- 6) Vlefshmërinë e përafërt të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të të vdekurit.

Në aktivdekje, sipas mundësisë, futen të dhëna edhe për vendin ku gjendet prona që e ka lënë i vdekuri, nëse ka pronë për mbajtjen, rruajtjen dhe lajmërimin e së cilës egzistojnë dispozita të posaçme, nëse ka para të gatshme, letra me vlerë, gjëra të vlefshme, librezë kursimi ose dokumente të tjera të rëndësishme, nëse i vdekuri ka lënë borxhe dhe sa, nëse ka lënë testament të shkruar ose kontratë për mbajtje të përgjeshme ose marrëveshje për heqje dore ose rindarjen e pasurisë gjatë jetës edhe ku ata ndodhen, ndërsa nëse i vdekuri ka bërë testament gojor atëherë edhe emri dhe mbiemri, profesioni dhe vendqëndrimi i dëshmitarëve para të cilëve është bërë ai testament. Në aktivdekje në mënyrë të posaçme shënohet nëse pritet lindja e fëmijës së të vdekurit, si dhe ajo nëse fëmijët e tij ose bashkëshorti kanë kujdestar. Nëse para trashëgimlënësit vdes bashkëshorti i tij, fëmija i tij, ose person tjetër i cili do të ishte thirrur në trashëgimi, në aktivdekje do të shënohet vendi dhe data e vdekjes së tyre.³³⁶

Në bazë të kësaj del se aktivdekja përmban të dhëna obligative dhe fakultative, të cilat kanë të bëjnë me trashëgimlënësin dhe trashëgimtarët e tij, si dhe për masën trashëgimore, dhe përmban edhe të dhëna për rrethana dhe fakte të caktuara, që mund t'i nevoiten gjykatës, respektivisht noterit jo vetëm për iniciimin e procedurës për zhvillimin e trashëgimisë por edhe për vazhdimin e saj dhe sjelljen e vendimit trashëgimor.

Prej të dhënave obligative aktivdekja duet të përmbajë të dhëna edhe atë:

- a) Për të vdekurin:
 - 1) Emri, emri i babait dhe mbiemri i të vdekurit, ndërsa për të vdekurit të gjinisë femrore edhe mbiemrin e vajzërisë, profesioni i të vdekurit, data e lindjes, shtetësia dhe numri amë.
 - 2) Dita muaji dhe viti dhe sipas mundësisë ora dhe vendi i vdekjes.
 - 3) Vendi ku i vdekuri ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin.
- b) Për trashëgimtarët e të ndjerit:
 - 4) Emri dhe mbiemri, datëlindja, profesioni, vendbanimi respektivisht vendqëndrimi i bashkëshortit pasëjetues dhe fëmijëve.
 - 5) Emri dhe mbiemri, datëlindja dhe vendbanimi ose vendqëndrimi i familjarëve të tjerë dhe personave të cilët mund të thiren në trashëgimi sipas ligjit, si dhe të personave që mund të thiren në trashëgimi sipas testamentit, dhe
- c) Për pasurinë e të vdekurit:
 - 6) Vlera e pasurisë së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të të vdekurit.

Në aktivdekje sipas mundësisë shënohen edhe të dhëna për vendin ku ndodhet pasuria e trashëgimlënësit, nëse ka pasuri për mbajtjen e së cilës, rruajtjen dhe paraqitjen egzistojnë dispozita të veçanta, nëse ka para të gatshme, letra me vlerë, sende të vlefshme, librezë kursimi ose dokumente të tjera të rëndësishme, nëse i ndjeri ka lënë detyrime (borxhe) sa ka lënë dhe cilit person.

Të dhënat fakultative ose plotësuese që përmban aktivdekja të cilat kanë të bëjnë me ndonjë trashëgimtarë ligjor, egzistimin e testamentit ose kontratës me të cilën trashëgimlënësi ka disponuar pasurinë e tij gjatë jetës.

Të dhëna të cilat i përmban aktivdekja për ndonjë trashëgimtarë janë: nëse pritet lindja e fëmijës së të vdekurit, si dhe nëse fëmijët dhe bashkëshorti që janë gjallë të trashëgimlënësit kanë kujdestar. Nëse para trashëgimlënësit ka

³³⁵ По аты, fq.121

³³⁶ Закон за вонпарнична постапка, сл.весник на РМ, 18.01.2008, член 145, стр.69-бр.9

vdekur bashkëshorti, fëmiu i tij ose personi tjetër i cili mund të thireshte në trashëgimi, në aktvdekje do të shënohet edhe vendi dhe data e vdekjes së tyre.³³⁷

СМРТОВНИЦА

Составена во ВРАПЧИШТЕ на ден 14/02/2017 година, бр. 11-1004/20

1	Име, татково име и презиме, законско прекар, занимање и датум на раѓање на умрениот	КАМИЛ БАЈРАМ МУСТАФИ, 10 (Десети) Јуни 1929
2	Ден, месец и година, а по можност и часот на смртта, место каде умрел, место и стан каде редовно живеел, како и се друго што би можело да биде од важност за надлежниот оставински суд.	14 (Четиринаесетти) Мај 1994, 12:00, МЕКА, САУДИСКА АРАБИЈА, ДЕБРЕШЕ, Тајовен број 18, Год. на упис 1994
3	Име, живеалиште и адреса на брачниот другар, а ако не е жив, кога и каде умрел, односно име и презиме на најблиските роднини-наследници	АТИЏЕ МУСТАФИ умрена
4	Име, возраст, занимање, живеалиште и стан на брачни и воображни, усвоени, полнолетни и малолетни деца на умрениот со назначување, по можност, денот на нивното раѓање, како и тоа дали се чека уште некое дете	1.Зулќуфли Мустафи син на пок.живее во Дебреше 2.Магбуле Шерифи ќерка на пок.живее Дебреше 3.Шазије Фетаи ќерка на пок.жена Сали живее во Дебреше
5	Име и живеалиште на старателот на децата, од оставителот кои што се неспособни за работа, ако ги има	4.Шукрије Синани ќерка на пок.жена на Шукур живее Врапчиште XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX Заклучен со реден бр.4(четири)
6	Фамилијарно и родено име, возраст, занимање, живеалиште и стан на оние роднини кои што се по законот или по изјавата на последна желба повикани на наследство:	XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX
7	Дали во оставината има освен движен имот уште и недвижен имот или книжни права и кои се:	XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX
8	Дали има познати долгови кои можат да ја преминат вредноста на оставениот имот, колку изнесуваат трошоците за болеста и законината и други долгови кои треба пред се да бидат измирени и кој ги измирил:	XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

Датумите во смртницата се земени по изјава на Шукрије Синани од град Врапчиште

Смртницата ја составил,
МАТИЈА
АБДУШУКУР ЗЕКИРИ

-Aktvdekje

1.4. Noterët si përfaqësues të gjykatës dhe kompetencat e Noterit

Autorizimet e noterëve në procedurën trashëgimore regullohen me Ligjin për procedurë jokontestimore. Risi paraqet paragrafi (2) i nenit 147 të Ligjit për noterinë ku parashihet se gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore obligohet pjesëmarrja e avokatit në cilësinë e të autorizuarit të secilit pjesëmarës, i cili mund të jetë edhe i autorizuar i përbashkët nëse midis palëve në procedurë nuk egziston kontest, gjithashtu zvogëlohet edhe shpërblimi për 50% e regulluar sipas nenit 17-22 të Tarifës për noterë.³³⁸

Sipas nenit 8, paragrafi (1) pika (1) e Tarifës për shpërblim dhe kompenzim të harxhimeve të punës së avokatëve („Gazeta zyrtare e R.M?” numër 126/16 tekst i pastër), është rregulluar shpërblimi i avokatëve për përpilimin e kontratave, kundërshtimeve etj., ndërsa pika (5) paragrafi (2) parashihet se në procedurën trashëgimore e cila zhvillohet para noterit, ku ligji obligon pjesëmarrjen e avokatit në këtë procedurë, shpërblimi dhe harxhimet për

³³⁷ Јаневски Аерсен, Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр. 122,123

³³⁸ Нотарска Тарифа, „Сл.Весник на Р.М., бр.226, Скопје, 30.12.2016

veprimet e ndërmara juridike të avokatëve pavarësisht numrit të tyre përbënë 50% të shpërblimit dhe harxhimeve të noterit, e cila dispozitë regullohet sipas nenit 153 paragrafi 6 i Ligjit për noterinë.

Sipas ligjit pjesëmarësit në procedurë 50% nga shpërblimi dhe harxhimet e noterit do t'i paguajnë avokatit, ndërsa 50% tjetër noterit, edhe atë noteri obligohet që mos të sjell vendimin trashëgimor derisa palët nuk e kanë paguar avokatin dhe noterin, dhe që noteri të jetë i sigurt për këtë duet patjetër të kërkojë nga avokati vërtetim me nënshkrim dhe vulë ose fletëpagesë të nxjerë nga banka së në atë procedurë trashëgimore janë paguar shpërblimit dhe harxhimet e avokatit.

Trashëgimtarët në mënyrë të proporcionale të pjesës që kanë trashëguar, obligohen të paguajnë në procedurë në pajtim me ligjin 153, paragrafi 6 i Ligjit për noterinë, taksë gjyqore në vlerë prej 480,00 denarë, shpërblimin e noterit në vlerë prej 4.800, 00 denarë dhe shpërblimin e avokatit në vlerë prej 4.800,00 denarë, ndërsa në pajtim me nenin 153 paragrafi 7 i Ligjit për Noterinë pjesëmarësit paralajmërohen se Vendimi do t'ju dorëzohet pas pagesës së shpërblimit të noterit dhe avokatit.

Noteri gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore duhet ta ketë parasysh edhe nenin 86 paragrafi 3 i Ligjit për procedurë kontestimore se avokatin mund ta zëvendësoj nëpunësi i tij profesional që e ka dhënë provimin e avokaturës, dhe i cili ka qenë në marrëdhënie pune tek i njëjti avokat, edhe atë vetëm para gjykatës së shkallës së parë, për konteste vlera e të cilave nuk e ka kaluar vlerën prej 1.000,00 denarë, me pajtim të palës.

Nëqoftëse gjatë vitit 2017 parashtohet kërkesë në gjyq për pasuri të re të gjetur për më parë nuk është zhvilluar procedura trashëgimore, noteri duhet të veproj sipas Ligjit të ri për noterinë, pa marrë parasysh se bëhet fjalë për një pjesë të pasurisë për të cilën më parë është zhvilluar procedurë, domethënë se me landën e re hapet numer i ri edhe në gjyq edhe tek noteri i cili vepron sipas ligjit të ri.

Që lëndët trashëgimore të zhvillohen sipas ligjit të ri për noterinë si pik kryesore duhet të miret data se kur gjyqi e ka pranuar propozimin për zhvillimin e procedurës trashëgimore.³³⁹

Gjykata ose ndonjë organ tjetër ka mundësi që noterit t'i besojnë punë të caktuara dhe të regulluara me ligj të veçantë. Puna e besuar mund të merret nga noteri për shkaqe të arsyeshme. Noteri përgjigjet për dëmin që mund t'ia shkaktojë palës gjatë ushtrimit të punës së besuar.³⁴⁰

Kryetari i gjykatës themelore është i autorizuar që në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë jokontestimore, lëndët trashëgimore t'ua besojë në veprim noterëve me seli në teritorin e gjykatës kompetente themelore. Noterët, si të besuar të gjykatës, ndërmarrin veprime dhe sjellin vendime në procedurën trashëgimore në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë jokontestimore. Gjykata nga disa shkaqe të rëndësishme siç janë: pamundësia për veprim të noterit për shkak të sëmundjes ose shkaqe tjera, për shkak të mos respektimit të dukshëm të detyrës zyrtare, si dhe për shkak të arsyeve tjera në bazë të vlerësimit të gjykatës, mund të ndërmarë nga noteri zbatimin e mëtutjeshëm të procedurës trashëgimore, dhe procedurën vetë ta zhvillojë ose t'ia besojë noterit tjetër.

Noterët si të besuar të gjykatës në procedurën trashëgimore, i ndërmarin vetëm ata lëndë trashëgimore, për të cilat në ditën e hyrejs në fuqi Ligjit për procedurë jokontestimore, nuk është ndërmarë asnjë veprim nga ana e gjykatës.³⁴¹

LITERATURA E SHFRYTEZUAR

1. A.Janevski, Dr.T.Zorska, E drejta procedurale civile, libri i parë E drejta kontestimore Shkup 2009.
2. А.Јаневски, Т.Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010.
3. Prof.dr.Faik Brestovci, E drejta procedural civile , Prishtinë 1997
4. Hamdi Podvorica, E drejta Trasgëgimore, Prishtinë 2006.
5. Emine Zendeli,Vizione n.11/12, pp. 78-87, Grafotex, Skopje, Macedonia, 1 / 2009, ISBN 1409-8962.
6. Дејан Мицкович, Ангел Ристов, Наследно право, Скопје, 2014,
7. Antic, B.Oliver, Nasledno pravo,NIP „Glas D.o.o., Beograd,2004,
8. Loius Grab, op. cit., стр.435.
9. Дејан Мицковиќ и Ангел Ристов, Наследувањеро во Европа, Љиљана Спировиќ Трпеновск, Скопје 2011,
10. Така Љиљана Спировиќ Трпеновска. Op.cit.,
11. Mihailo Konstantinović, Opšte napomene uz teze za predprojekt zakona o nasleđivanju, Arhiv za pravne i društvene nauke, br.3/1947,

³³⁹ Нотарска Комора на Република Мекедонија, Мислења и ставови, бр.02-638/1 од 17.02.2017 година, Скопје

³⁴⁰ Закон за нотаријатот, сл.весник, бр.72, член 148, стр.32, 12.04.2016

³⁴¹ Јаневски Аерсен, Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр. 116,117,119,120

12. Vlada Republike Srbije, Komisija za Izradu Građanskog zakonika, Rad na izradi na Građanskog zakonita, izveštaj Komisije za otvorenin pitanjima, Beograd, 2007,
13. Dejan Đurđević, „ Sloboda testiranja i formalizam olografskog testamenta,, Pravni Život, br.11/2009.
14. § 2232, BGB
15. Г.Г Черемных НАСЛЕДСТВЕННОЕ ПРАВО, учебник, Россииская академия, адвокатуры и нотариата, Москва 2009,
16. Hamdi Podvorica , E drejta trashwgimore e RPSH, Shtwpia botuese libri universitar , Tiranw , 1988.
17. Hamdi Podvorica , Trashwgimia e domosdoshme , revista , E drejta e fakultetit Juridik tw Universitetit tw Prishtinws nr.1/7
18. Nazmi Bicaku , E drejta e trashwgimisw e RPSH, shtwpia botuese libri universitar , Tiranw, 1988
19. Luliana Fuga , Trashwgimia me testament, Lilo, Tiranw, 1999.
20. Luliana Fuga , Trashwgimia, Iliri, 2002 , Tiranw.